Njoftim për përqendrim me të cilin Schmitz Cargobull AG, Gjermani, do të fitojë kontrollin mbi pjesë të aseteve dhe veprimtarisë afariste të Lamberet SAS, Francë

(Lënda nr. 08-160/2026)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 12.11.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim, me të cilin Schmitz Cargobull AG, me seli të regjistruar në Bahnhofstraße 22, 48612 Horstmar, Gjermani, do të fitojë kontroll të pavarur mbi pjesë të aseteve dhe veprimtarisë afariste të Lamberet SAS, shoqëri në procedurë të riorganizimit gjyqësor, me seli të regjistruar në 129 Route de Vonnas, 01380 Saint-Cyr-sur-Menthon, Francë.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe veprimtaritë e tyre afariste:

Schmitz Cargobull AG është shoqëri familjare e themeluar në Gjermani, e cila merret me prodhimin dhe shpërndarjen e gjysmërimorkiove dhe rimorkiove. Schmitz Cargobull AG prodhon mjete për transportin e mallrave për industri të ndryshme, duke përfshirë industrinë ushqimore, të pijeve, të mallrave të ngrira, industrinë farmaceutike, bujqësinë dhe pylltarinë, shërbimet e korrierit, materialet ndërtimore dhe industrinë automobilistike.

Në Maqedoninë e Veriut, Schmitz Cargobull AG realizon të ardhura dhe ka prani të regjistruar nëpërmjet shoqërisë së saj të varur – SHMITZ KARGOBUL MAQEDONIA SHPKNJP Ilinden, Ilinden, me seli të regjistruar në rr. „34“, nr. 3, Ilinden, 1000 Shkup, me veprimtari prioritare 46.900 – tregti me shumicë jo e specializuar.

Objekt i përqendrimit janë pjesë të aseteve dhe veprimtarisë afariste të Lamberet SAS.

Lamberet SAS është një nga subjektet kryesore në Evropën Perëndimore, e specializuar në projektimin, prodhimin dhe shitjen e karrocerive me temperaturë të kontrolluar për automjete komerciale, kamionë dhe gjysmërimorkio.

Asetet e synuara përfshijnë aktivitetet e zhvillimit, prodhimit dhe shitjes së divizionit „Automjete industriale“ të grupit Lamberet, i cili ushtron veprimtarinë në lokacionet prodhuese në Saint-Cyr-sur-Menthon dhe Sarreguemines, Francë. Përkatësisht, lokacioni prodhues në Saint-Eusèbe, Francë, ku janë të përqendruara aktivitetet kryesore të Lamberet që lidhen me automjetet e lehta komerciale, përjashtohet nga objekti i përqendrimit.

Asetet e synuara përfshijnë gjithashtu punëtoritë dhe degët e shitjes në vijim, në Francë:

- 75 rue Antoine Manigand – 01540 Vonnas;
- Rue René Tayon – 56100 Lorient;
- 48 rue du Dauphiné – 69800 Saint-Priest;
- 1 rue du Vallon – 94440 Marolles-en-Brie.

Asetet e synuara përfshijnë më tej edhe aktivitetet që Lamberet SAS i ushtron në Gjermani dhe Spanjë, nëpërmjet pjesëmarrjeve të saj në kapitalin e shoqërive të varura, si vijon:

- LAMBERET DEUTSCHLAND GmbH – 100% e pjesëmarrjes në kapital dhe e të drejtave të votës;
- LAMBERET VEHICULOS FRIGORIFICOS – 100% e pjesëmarrjes në kapital dhe e të drejtave të votës;
- KERSTNER GmbH – 15% e pjesëmarrjes në kapital dhe e të drejtave të votës janë në pronësi të drejtpërdrejtë të Lamberet SAS, ndërsa pjesa e mbetur është në pronësi të LAMBERET DEUTSCHLAND GmbH dhe, rrjedhimisht, do të fitohet në mënyrë të tërthortë. KERSTNER GmbH menaxhon lokacionin për automjete të lehta komerciale në Gross-Rohrheim (Gjermani). Nëpërmjet KERSTNER, Lamberet zhvillon zgjidhjet e veta për ftohje për automjetet e lehta komerciale.

Asetet e synuara nuk kanë qenë aktive dhe nuk kanë realizuar të ardhura në Maqedoninë e Veriut gjatë vitit 2025.

Për qëllimet e vlerësimit të përqendrimit në fjalë, parashtruesi i njoftimit propozon që tregu përkatës të përkufizohet si tregu i shitjes me shumicë të gjysmërimorkiove në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar mbi këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara që të dorëzojnë vërejtje dhe mendime në lidhje me këtë përqendrim pranë Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr.54, Shkup ose përmes e-mailit: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda afatit prej 10 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

20.11.2026

Shkup